

Shtohen rastet e të infektuarve me Covid në Kosovë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA TAKUAR PËRFAQËSUESIT E SHOQATAVE TË DALA NGA LUFTA E UÇK-së | FAQE 4-5

KURTI NUK I MERR PARASYSH KËRKESAT E VETERANËVE TË UÇK-së

- Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protesta deri në realizimin e kërkesave të tyre



Kryeministri Albin Kurti me bashkëpunëtorë ka pritur të premtën në takim përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së me të cilët ka diskutuar për kërkesën e veteranëve që të përfshihen në ligjin që rregullon pagën minimale. Pas këtij takimi, ushtruesi i detyrës i OVLUÇK-së, Faton Klinaku, kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari

dhe ai i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, kanë thënë se Kurti nuk kishte gatishmëri t'i marrë parasysh kërkesat e veteranëve. Sipas tyre, Kurti do t'ua dorëzojë me shkrim propozimin e vet për veteranët. Klinaku, Jashari dhe Shurdhaj kanë bërë me dije se nuk do t'i ndalin protestat deri në realizimin e kërkesave të veteranëve të UÇK-së

AKTUALE



TË NDËRPRITET ZVARRITJA E PROJEKTLIGJIT PËR FINANCIIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE | F. 5

PDK-ja PËR VENDIMIN E SUPREMES PËR ENERJINË: I NDIKUAR POLITIKISHT DHE NË DËM TË QYTETARËVE | F. 6

MASHTI: KA AVANCIM NË PROCESIN E ADMINISTRIMIT TË PJESËS SË DYTË TË TESTIT TË ARRITSHMËRISË | F. 7

EKONOMI



KOSOVA, VENDI I RADHITUR MË SË LARTI PËR PRANIMIN E REMITANCAVE NË EVROPË | F. 8

ATK-ja: PERSONAT TË CILËT MERRN ME AKTIVITETE AFARISTE JANË TË DETYRUAR T'I DEKLAROJNË TATIMET | F. 8

SPORT

CHAMPIONS LEAGUE FTON YLLIN TË APLIKOJË PËR PJESËMARRJE NË RAUNDIN KUALIFIKUES | F. 10

LAJÇAK: NUK GUXOJ TË THEM NJË DATË, POR LIBERALIZIMI I VIZAVE PO VJEN | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

WB6: 'Ballkani i hapur' do të konkurrojë negativisht me Procesin e Berlinit

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Projekti i "Ballkanit të hapur" do të konkurrojë negativisht me Procesin e Berlinit dhe do ta udhëheqë integrimin rajonal në një drejtim të fragmentuar, thotë Grupi Strategjik 6 i Ballkanit Perëndimor (WB6).

Sipas kësaj organizate për demokraci dhe të drejtat e njeriut, me seli në Sarajevë, "Ballkani i hapur" dhe Procesi i Berlinit kanë të bëjnë me të njëjtat çështje - lëvizjen e lirë të njerëzve, shërbimeve, mallrave dhe kapitalit.

Procesi i Berlinit ka një grup të qartë standardesh të vendosura nga acquis communautaire (legjislacioni i BE-së), thotë ky grup. "Procesi i Berlinit", iniciativë diplomatike e ish-kancelares gjermane Angela Merkel, është jetësuar në vitin 2014, me qëllim të mbështetjes së një të ardhme paqësore, të qëndrueshme dhe demokratike të Ballkanit Perëndimor, si dhe për ta përmirësuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian të rajonit.

Nisma "Ballkani i hapur" është vazhdimësi e "Minishengenit" ballkanik, e paraqitur në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019 nga liderët e Serbisë, të Maqedonisë së Veriut dhe të

Shqipërisë. "Ballkani i hapur" nuk është i lidhur me asnjë standard të BE-së dhe liderët rajonalë mund ta drejtojnë atë në rrugë që nuk mund të kontrollohen nga perspektiva e politikës së zgjerimit të BE-së", ka thënë organizata në një deklaratë.

Më tej thuhet se nismëtarët e "Ballkanit të hapur" shmangin shpjegimin sesi projekti do të pajtohet me Procesin e Berlinit dhe politikën e zgjerimit, si dhe me tregun e mëtejshëm të përbashkët rajonal dhe sa i realizueshëm do të ishte krijimi i dy kornizave që synojnë ta rregullojnë të njëjtën gjë.

Në deklaratë përmenden dilemat e Kosovës, Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi - që nuk janë pjesë e "Ballkanit të hapur" - lidhur me natyrën gjithëpërfshirëse të nismës. "Ka shqetësime se projekti 'Ballkani i hapur' po krijon një hendek në mes të partnerëve transatlantikë. Shumë kryeqytete evropiane nuk janë të bindura në këtë projekt, sepse prej kohësh po dështon ta sigurojë zbatimin e parimeve të gjithëpërfshirjes dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së", shton Grupi Strategjik 6 i Ballkanit Perëndimor.

Organizata shton se Serbia, si një



nga nismëtarët e "Ballkanit të hapur", po përballen me njoftime për ngadalësimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sepse mbetet këmbëngulëse për shmangien e harmonizimit të plotë me sanksionet e BE-së kundër Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës. "Në këtë kuptim, 'Ballkani i hapur' ka potencialin të krijojë ndarje dhe ta dëmtojë natyrën e bashkëpunimit rajonal në baza të barabarta", thuhet në deklaratë.

Procesi i Berlinit është krijuar më 2014 mes rritjes së

euroskepticizmit dhe vendimit të atëhershëm të BE-së që nuk do të ketë pranim të anëtarëve të rinj në pesë vjetët e ardhshëm.

Në kuadër të "Ballkanit të hapur", në samitin e fundit, që është mbajtur në Ohër në fillim të muajit qershor, janë nënshkruar marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe titujve shkencorë dhe tre memorandumë bashkëpunimi në fushën e turizmit, kulturës dhe luftimit të evazionit fiskal.

Për herë të parë në këtë nismë kanë marrë pjesë përfaqësuesit më të lartë të Malit të Zi dhe

Bosnjë-Hercegovinës, në cilësinë e vëzhguesve.

Deri më tani të tria vendet anëtare kanë arritur një sërë marrëveshesh që synojnë nxitjen e bashkëpunimit rajonal: kalimin e kufijve të qytetarëve të tyre me karta identiteti, një marrëveshje për bashkëpunimin në lehtësimin e importit, eksportit dhe lëvizjes së mallrave në Ballkanin Perëndimor, dhe një memorandum mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në tregun e punës. Është bërë me dije se këto shtete do t'i heqin kontrollat doganore nga 1 janari 2023.

KE-ja rekomandon statusin kandidat për Ukrainën dhe Moldavinë

KIEV, 17 QERSHOR - Komisioni Evropian ka rekomanduar dhënien e statusit të vendit kandidat për Ukrainën, bëri me dije presidentja e këtij institucioni, Ursula von der Leyen. "Ne rekomandojmë që t'i japim Ukrainës statusin e vendit kandidat, duke nënkuptuar që vendi duhet të kryejë një sërë reformash të rëndësishme. Ukraina ka treguar përkushtim për t'i respektuar vlerat dhe standardet evropiane", ka theksuar von der Leyen.

Presidentja e KE-së tha se rekomandimi për Ukrainën ka ardhur pas një shqyrtimi të thellë të gatishmërisë të këtij shteti për statusin e kandidatit, përfshirë edhe kriteret politike dhe ato ekonomike. Sipas von der Leyen, Ukraina ka dëshmuar se ka një sistem të duhur politik dhe funksional, teksa vitet e fundit ka përfunduar legjislaturën e saj me BE-në. Ajo tha se Ukraina ka bërë shumë në sundimin e ligjit dhe tani fokusi do të jetë në gjyqësor dhe në mënyrën e emërimit të gjykatësve.

Në takimin e mbajtur më 17 qershor, Komisioni Evropian ka



rekomanduar edhe dhënien e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE edhe për Moldavinë, por nuk i ka dhënë këtë rekomandim edhe Gjeorgjisë.

Në rastin e Gjeorgjisë është vlerësuar aspirata e këtij shteti

për integrim në bllok, por KE-ja ka rekomanduar vetëm dhënien e "perspektivës evropiane" për Gjeorgjinë.

Rekomandimet e 17 qershorit të KE-së do të diskutohen nga liderët e BE-së gjatë takimit më 23 dhe 24 qershor në Bruksel, ku

do të merret vendimi përfundimtar për rekomandimet e Komisionit Evropian.

Asnjëherë më parë një mendim i tillë nuk është dhënë kaq shpejt për anëtarësim në Bashkimin Evropian, vendim që duhet të

miratohet nga të 27 shtetet anëtare.

Ky takim i komisionit vjen një ditë pasi katër liderë evropianë vizituan Ukrainën dhe shprehën mbështetjen e tyre për dhënien e "menjëherë" të statusit të kandidatit, teksa Kiev po përballen me pushtimin e përvokuar të Rusisë.

Franca, Gjermania, Italia dhe Rumania janë në favor që Ukraina ta marrë "menjëherë" statusin e vendit kandidat, tha më 16 qershor në Kiev presidenti i Francës, Emmanuel Macron.

Vizita e liderëve evropianë në Kiev kishte një simbolikë të fuqishme se BE-ja mbështet Zelenskyn, i cili i ka bërë thirrje bllokut evropian që t'i ofrojë shtetit të tij anëtarësim përmes procedurave të shkurtuara, duke argumentuar se një gjë e tillë do të ishte "përgjigje e fuqishme" ndaj pushtimit të përvokuar rus.

Zelensky ka dorëzuar aplikacionin e Ukrainës për anëtarësim në BE pak kohë pas nisjes së pushtimit rus më 24 shkurt, ndërkaq Moldavia dhe Gjeorgjia kanë bërë një gjë të tillë pak kohë pas Kievit.

BE-ja pret që tema e energjisë të finalizohet javën e ardhshme

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Bashkimi Evropian pret që në javën e ardhshme delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë ta finalizojnë temën e energjisë, kështu tha për "Radion Evropa e Lirë", zëdhënësi i BE-së për Çështje të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Peter Stano. "BE-ja pret që palët ta mbyllin çështjen e energjisë gjatë javës së ardhshme në Bruksel në nivel të kryenegociatorëve", tha ai përmes një deklarate me shkrim.

BE-ja ka qenë e pranishme në takimin e mbajtur javën e kaluar midis palës serbe dhe Kompanisë për Distribimin e Energjisë Elektrike (KEDS), në Stamboll të Turqisë. KEDS nga viti 2013 është nën menaxhimin e konsorciumit turk "Çalik-Limak". Kjo kompani ka ekskluzivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tërë territorin e Kosovës, menaxhon dhe mirëmban asetet në terren. Në fillim të javës

kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, paralajmëroi se për çështjen e energjisë janë afër finalizimit të një pajtimi me palën serbe. Ai tha se kjo çështje do të rregullohet "duke respektuar marrëveshjen e arritur në muajin prill të vitit 2013".

Marrëveshja e vitit 2013, e arritur në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, parasheh që, përveç KEDS-it, në Kosovë të licencohet edhe një kompani tjetër për shpërndarjen e rrymës.

Marrëveshja është konfirmuar në gusht të vitit 2015 nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës dhe nga i Serbisë, por nuk është zbatuar asnjëherë.

Aktualisht qytetarët serbë që jetojnë në veri të Kosovës nuk paguajnë për energjinë e shpenzuar. Sipas Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në



Kosovë (KOSTT), humbjet nga faturat e energjisë në veri vetëm për vitin 2021 kanë arritur shumën prej 40 milionë eurosh. Nga viti 1999 deri më 2017 borxhin për veriu të Kosovës e

kanë paguar qytetarët e Kosovës nga komunat në jug të Ibrit. Por, më 2017, një praktikë të tillë e pezulloi Gjykata e Apelit, pasi u vlerësua se një gjë e tillë ishte e paligjshme. Më

vonë ky vendim u konfirmua edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Faturat për energjinë e shpenzuar në veri të Kosovës i paguan KOSTT-i, gjegjësisht Qeveria e Kosovës.

Lajçak: Nuk guxoj të them një datë, por liberalizimi i vizave po vjen

PRISHTINË, 17 QERSHOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në një intervistë për "Euronews Albania", ka thënë se Kosova ka plotësuar të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave. Ai ka theksuar se nuk guxon të thotë një datë, por liberalizimi i vizave po vjen. "Sërisht ka një mendim mjaft të palëkundur mes shteteve anëtare të BE-së që Kosovës i duhej dhënë liberalizimi i vizave shumë kohë më parë. Nuk ka asnjë dyshim që Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për ta hequr sistemin e vizave dhe problemi qëndron sërisht te mungesa e konsensusit, por mund të them që kjo problematikë po ngrihet mes vendeve anëtare shumë më shpesh, gjatë takimeve të organeve të ndryshme evropiane ndaj mendoj se është afër. Nuk guxoj të them një datë, por ajo po vjen dhe



këtë e them me siguri të plotë", ka thënë Lajçak.

Duke folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, ai ka

theksuar se është bërë shumë punë dhe ka pasur përparim

edhe pse, sipas tij, kjo nuk ka qenë dhe aq e dukshme. "E vërteta është se dy kryenegociatorët po takohen çdo muaj në Bruksel dhe ne po diskutojmë për implementimin e marrëveshjeve të shkuara që janë miratuar para disa vjetësh, por nuk janë implementuar. Ne po diskutojmë rreth çështjeve të ditëve të sotme për t'u siguruar që ato të mos kthehen në probleme të mundshme dhe, së fundmi, po punojmë edhe për të ardhmen e marrëveshjes së normalizimit", ka thënë Lajçak. Ai ka bërë me dije se në javën e ardhshme do të kenë një tjetër takim mes kryenegociatorëve ndërmjet dy vendeve. "Me shpresë ne do të mund të njoftojmë rreth një marrëveshjeje shumë të rëndësishme. Unë, gjithashtu, po shpresoj t'i bëj të dy liderët bashkë në Bruksel për takimin e tretë të nivelit të lartë përpara pushimeve të verës", ka deklaruar Lajçak.

Osmani takon tre emisarët për rajonin

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, po merr pjesë në Forumin e Prespës që po mbahet në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Ajo ka pasur takime të ndara me të dërguarin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara, Gabriel Escobar, të dërguarin e posaçëm të Mbretërisë së

Bashkuar, Stuart Peach, si dhe me të dërguarin e posaçëm të Gjermanisë, Manuel Sarrazin. "Integrimi i Kosovës dhe vendeve të tjera demokratike të rajonit në strukturat euroatlantike është përgjigja e vetme për ta parandaluar agjendën destabilizuese dhe ndikimin keqdashës të Rusisë dhe

satelitëve të saj në rajonin tonë. Angazhimi i partnerëve tanë në Ballkanin Perëndimor është hapi i duhur drejt rienergizimit të procesit integruar, i cili siguron paqen e qëndrueshme, sigurinë dhe demokracinë në rajonin tonë", ka shkruar Osmani në "Facebook".





Kryeministri Albin Kurti ka takuar përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së

Kurti nuk i merr parasysht kërkesat e veteranëve të UÇK-së

- Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protesta deri në realizimin e kërkesave të tyre

Kryeministri Albin Kurti me bashkëpunëtorë ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, me të cilët ka diskutuar në lidhje me kërkesën e veteranëve që të përfshihen në ligjin që rregullon pagën minimale. Pas këtij takimi, ushtruesi i detyrës i OVLUÇK-së, Faton Klinaku dhe kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari dhe ai i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, kanë thënë se Kurti nuk kishte gatishmëri që t'i marrë parasysht kërkesat e veteranëve. Sipas tyre, Kurti do t'ua dorëzojë me shkrim propozimin e tij për veteranët. Në këtë kontekst, Klinaku, Jashari dhe Shurdhaj kanë bërë me dije se nuk do t'i ndalin protestat deri në realizimin e kërkesave të veteranëve të UÇK-së

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Me ftesë të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të premten është mbajtur takim me përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, Faton Klinaku, ushtrues detyre i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Xhavit Jashari, kryetar i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së, Fadil Shurdhaj, kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës

së UÇK-së dhe kryetarët e disa degëve të organizatës së veteranëve të luftës çlirimtare.

Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, këshilltari i kryeministrit për çështje të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, Aziz Bici dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere, Armend Muja.

Siç ka njoftuar Zyra e Kryeministrit, në këtë takim është ritheksuar përkushtimi i Qeverisë së Kosovës për thellimin

e bashkëpunimit me Organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së veteranëve të UÇK-së. "U bisedua edhe për çështjen e pastrimit të listave dhe mundësitë e bashkëpunimit në këtë aspekt, si dhe për tema të tjera të rëndësishme lidhur me statusin dhe gjendjen e veteranëve të luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka njoftuar Zyra e Kryeministrit.

Klinaku: S'ka marrëveshje, i vazhdojmë protestat

Përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së kanë dhënë një prononcim për medie pas takimit me kryeministrin Albin Kurti. Fillimisht, ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka bërë me dije se me kryeministrin Kurti nuk janë pajtuar që veteranët të jenë pjesë e ligjit që rregullon pagën minimale. "Me kryeministrin nuk u pajtuam sepse ne kërkuam që të kthehet pika 3.1, të cilin e ka ndryshuar kjo qeveri, me Kuvendin e Kosovës. Me atë pikë e kanë larguar përfitimin e veteranit të luftës që me ligj është se nuk mund të jetë më pak se paga minimale. I kërkuam që pika 3.1 të kthehet dhe nëse nuk ndodh kjo, ne në seancat që do të mbahen do t'i vazhdojmë protestat derisa kjo çështje të rregullohet. Në qoftë se këta e rregullojnë këtë çështje më mirë

sesa ka qenë, është punë e çdo qeverie që të kontribuojë më shumë për kategoritë e dala nga lufta apo edhe për shtresat e tjera të shoqërisë", ka thënë Klinaku, duke shtuar se Kurti u ka thënë se propozimin e tij për çështjen e veteranëve do ta bëjë me shkrim, por pa specifikuar datën e këtij propozimi. "Përpos këtyre çështjeve që nuk u pajtuam, ai na tha se do të na propozojë diçka me shkrim. Po presim çfarë do të na dorëzojë me shkrim, por qëndrimi ynë mbetet vetëm te pika 3.1 e ligjit sepse është bërë shkelje ligjore", ka thënë Klinaku.

Më tutje, Klinaku ka thënë se ia kanë bërë me dije Kurtit se nëse nuk merren parasysht kërkesat e veteranëve të UÇK-së, protestat do të vazhdojnë. "Ditën që do ta thërrasin seancën për votimin e leximit të dytë të ligjit, i treguam Kurtit se do të jemi në protestë. Nëse e rregullojnë ligjin siç ka qenë apo edhe më mirë ne do t'i duartrokasim. Por, nëse e heq pikën 3.1, do të na ketë në protesta

Të ndërpritet zvarritja e projektligjit për financimin e subjekteve politike

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Në mars të këtij viti Kuvendi i Kosovës kishte miratuar në parim projektligjin për financimin e subjekteve politike. Megjithatë, pavarësisht se Rregullorja e Punës përcakton që, pas miratimit në parim, raporti për projektligjin duhet të silllet në Kuvend brenda dy muajve, ky afat nuk është respektuar nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere. Përveç afateve procedurale, ky projektligj ka tejkaluar edhe afatet e përcaktuara në Programin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së për vitet 2021-2025, ndërsa është në fund edhe të afateve të përcaktuara në Agjendën për Reforma Evropiane (ERA) 2. Në lidhje me këtë kanë reaguar organizatat Demokracia Plus (D+), Demokraci për Zhvillim

(D4D), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Lëvizja FOL, Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet Çohu. Sipas këtyre organizatave, zvarritja e këtij procesi shpërfaqet edhe nga numri minimal i takimeve dhe diskutimeve të zhvilluara nga grupi punues për këtë projektligj me vetëm një dëgjim publik të organizuar deri më tani. "Për më tepër, puna e këtij grupi punues nuk ka qenë transparente dhe gjithëpërfshirëse në raport me organizatat e shoqërisë civile, siç ndodh rëndom me projektligje të kësaj rëndësie. Vonesat në miratimin e këtij projektligji mbi bazën e rekomandimeve të Komisionit të Venedikut flasin për një qasje joserioze të Kosovës ndaj



opinioneve të këtij komisioni, të cilat rrezikojnë të mos jenë konsistente me situatën e tanishme, duke marrë parasysh kohën e gjatë që u është dashur institucioneve deri në miratimin e projektligjit. Prandaj, ne, organizatat e

poshtëshënuara të shoqërisë civile, kërkojmë që Kuvendi dhe konkretisht nga Komisioni Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfere ta shtojnë punën e tyre me qëllim të përmbylljes së sagës me këtë projektligj, i cili ka mbetur i pamiruar tash e

katër vjet, në tri legjislatura të ndryshme", është theksuar në reagimin e këtyre organizatave. Po ashtu, këto organizata kanë kërkuar që grupi punues dhe komisioni parlamentar në përgjithësi, t'i përfshijnë organizatat e shoqërisë civile gjatë punës së tyre si dhe të marrë në konsideratë rekomandimet e tyre që janë në funksion të avancimit të mëtejshëm të këtij projektligji. "Para tre vjetësh, si organizata të shoqërisë civile, kishim organizuar 'Marshin e refuzimit' përmes të cilit kundërshtuam ndryshimet e projektligjit që cenonin transparencën dhe llogaridhënien financiare të subjekteve politike, si dhe cenimin e rolit të zyrës në kuadër të kontrollit financiar", është thënë në reagimin e këtyre organizatave.

Konjufca: Rrugët janë testamenti më i vjetër i njerëzimit



PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë në Konferencën Parlamentare Ndërkombëtare "E ardhmja e transportit", e cila është mbajtur të premten në Prishtinë nën organizimin e Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, mbështetur nga Friedrich Ebert Stiftung. Konferencën e hapi kryetarja e komisionit, Fitore Pacolli-Dalipi, e cila foli për rëndësinë e kësaj konference dhe rezultatet

e synuara. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, në fjalën e tij para të pranishmëve, e konsideroi të një rëndësie të veçantë mbajtjen e kësaj konference. "Tema të cilën po e trajtojmë sot është shumë e rëndësishme dhe ka marrë vëmendje tejet të madhe, sidomos pas zhvillimeve të fundit që po i shohim në botë, e veçanërisht agresionit rus në Ukrainë", ka theksuar Konjufca. Kreu i Kuvendit tha se çdoherë kur mendohet dhe diskutohet rreth transportit, duhet të

mendohet për zhvillimin e qëndrueshëm i cili, sipas tij, kërkon edhe bashkëpunim në mes të palëve dhe sektorëve të ndryshëm, duke qenë në harmoni të plotë me komunitetin. "Rrugët janë testamenti më i vjetër i njerëzimit për shkak të nevojës së njerëzve që të jenë të lidhur mes vete", është shprehur Konjufca. Konferenca ka vazhduar punimet me penalistët ndërkombëtarë, të cilët kanë ndarë përvojat e tyre nga shtetet prej nga vijnë.

çdo ditë, në protesta të vazhdueshme", është shprehur Klinaku. Sipas Klinakut, Kurti si argument për mospërfshirjen e veteranëve të UÇK-së në ligjin që rregullon pagën minimale e ka përmendur numrin e madh të tyre. "Ai thirret në numrin e madh të veteranëve, por nuk është çështje e tij, por e gjykatës sepse ne e kemi lëndën në gjykatë dhe duhet të pritet vendimi", ka thënë Klinaku. Në këtë kontekst, Klinaku ka deklaruar se arsyetimet e Kurtit me bashkëpunëtorë janë të pabaza: "Edhe nëse bëhet një komision i ri për veteranët, verifikimi i tyre do të bëhet prapë përmes atyre komandantëve". Kurse kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, ka thënë se kanë kërkuar nga Kurti që të kthehet ligji bazë i veteranit ku përcaktohen përfitimet e tij. Ai ka theksuar se nga ana e Kurtit nuk kishte gatishmëri që të reflektojë. Në këtë drejtim, Jashari ka thënë se do ta

kundërshtojnë fuqishëm Projektligjin për pagën minimale deri në realizimin e së drejtës së tyre. "U pa se nuk ishte gatishmëri që të reflektojnë dhe ne jemi këtu dhe do ta kundërshtojmë fuqishëm deri në realizimin e së drejtës", ka thënë Jashari, duke shtuar se do ta presin propozimin me shkrim të kryeministrit Kurti dhe ministrit të Financave, Hekuran Murati. "E presim përgjigjen me shkrim dhe propozimin që do ta bëjnë kryeministri dhe ministri i Financave. Ishim aty për t'u thënë se kanë bërë shkelje ligjore. Kemi biseduar se nuk është detyrë e ministrit dhe kryeministrit lista e veteranëve. Unë që jam pjesë e këtij procesi i thashë se shkalla e parë ka vendosur pro komisionit se nuk është gjetur shkelje, por presim që kjo të ndodhë dhe me rigjykim", është shprehur Jashari. Në anën tjetër, Fadil Shurdhaj, kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, ka thënë se biseda me kryeministrin Kurti

ishite mjaft e mundimshme. "Rrjedha e bisedimeve ishte goxha e mundimshme dhe e gjatë. Megjithatë, nuk kemi mundur të arrijmë ndonjë konsensus ose mirëkuptim nga kryeministri dhe ministri i Financave. Presim reflektim dhe propozim me shkrim se çfarë do të ndryshojnë apo propozojnë", ka deklaruar Shurdhaj. Kuvendi i Kosovës më 14 qershor ka miratuar në parim Projektligjin për rritjen e pagës minimale në 250 euro neto. Por, në pikën 3.1 është thënë se për pensionet e veteranëve, që aktualisht kapin vlerën e 170 eurove deri në kategorizimin e listës përfundimtare të veteranëve, qeveria do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve. Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së kanë organizuar dy protesta deri më tani, duke kërkuar që pensionet e veteranëve të jenë në lartësinë e njëjtë me atë të pagës minimale. Protesta e 16 qershorit të



veteranëve, e mbajtur para Kuvendit të Kosovës, është mbështetur edhe nga partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të cilat e kanë pamundësuar vazhdimin e seancës plenare ku ishte paraparë të diskutohet për tërheqjen e mjeteve nga Trusti. Kujtojmë se aktualisht është në proces gjyqësor rasti i njohur si

"Veteranët", në të cilin dyshohet se mbi 19 mijë persona kanë fituar në mënyrë të paligjshme statusin e veteranit të UÇK-së. Aktualisht, sipas të dhënave zyrtare nga Qeveria e Kosovës, statusin e veteranit luftëtar e kanë 53 mijë e 188 persona kurse, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 37 006 persona janë përfitues nga skema për veteranët e luftës.

Partneriteti efektiv me Slloveninë është në interes të sigurisë rajonale dhe më gjerë

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Në kuadër të angazhimit për thellimin e bashkëpunimit me vendet partnere të rajonit tonë, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të premtën në takim ambasadorën e Sllovenisë në Kosovë, Minca Benedejcic.

Në këtë takim u diskutua për thellimin e partneritetit në mes dy vendeve tona, përveç të tjerash, edhe në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. "Përvoja e Sllovenisë për proceset integruese në iniciativat dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë, si dhe në NATO, është shumë e rëndësishme për ne, andaj edhe kërkojmë mbështetjen e qeverisë sllovene", ka theksuar ministri Mehaj me këtë rast.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se ky bashkëpunim, përveç në interesin e dy vendeve, është me



rëndësi shumë të madhe edhe për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e përgjithshëm rajonal e më gjerë.



Në ambulancat specialiste për pesë muaj u kryen 70 mijë vizita

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, respektivisht në ambulancat specialiste, është shënuar rekord shifrash të vizitave gjatë periudhës janar-maj 2022. Sipas raportit të punës, u kryen 70 227 vizita.

Më së shumti pati në muajin mars, në të cilin janë realizuar 17 027 vizita ambulatore- specialiste, kurse gjatë muajit janar kishte 11 695 vizita në ambulancat specialiste, më së paku për këtë periudhë kohore.

PDK-ja për vendimin e Supremes për energjinë: I ndikuar politikisht dhe në dëm të qytetarëve

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË 17 QERSHOR - Vendimi i Gjykatës Supreme, që anulon dy vendimet gjykatave themelore dhe të apelit, të cilat kishin konsideruar rritjen e çmimit të energjisë të kundërligjshme, është në dëm të qytetarëve dhe i ndikuar politikisht. Kështu kanë thënë të premtën në një konferencë për medie zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës, Faton Abdullahu dhe avokati Faton Fetahu. "Të dyja këto gjykata kanë qenë të një mendimi se kjo rritje është bërë edhe në kundërshtim me ligjin dhe në kundërshtim me përpjekjen tashmë të munguar - që qytetari i Kosovës të mbrohet nga shtrenjtimi i energjisë elektrike. Ne e kundërshtojmë ashpër këtë vendim të Gjykatës Supreme duke e konsideruar atë si vendim të ndikuar politikisht nga qeveria aktuale. Gjykata Supreme duket se ka qenë e prirë nga interesa të tjera klanore, karrieriste dhe posaçërisht



politike", ka thënë Abdullahu. Sipas zëdhënësit të PDK-së, po të mos ishte kështu e ndikuar, do të vendoste ashtu sikundër do ta udhëzonin normat dhe ligjet në fuqi dhe ashtu siç kanë vendosur tashmë Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. "Në kohën kur çmimet e artikujve bazë janë rritur

papërbalueshëm, ata vazhdojnë të mos kenë të ndalur në rritje. Në kohën kur inflacioni po rritet ashtu si kurrë më parë në këto vitet e fundit, muajin e fundit që lamë, pra në maj, inflacioni është 12.5 për qind. Në kohën kur një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës, sidomos të rinjtë, mendojnë më

seriozisht se kurrë që në mundësinë e parë ta lënë Kosovën për të kërkuar punë jashtë vendit, vendimi i Gjykatës Supreme është vendim i padrejtë për nga mungesa e sensit për të kuptuar se si jeton qytetari i Kosovës, për nga mungesa e profesionalizmit, profesionalizëm ky që bie viktimë e politikës

arrogante që mendon se drejtësia në politikë e qeveri është mbi drejtësinë në gjykata", ka thënë Abdullahu.

Më tej, ai ka shtuar se Partia Demokratike e Kosovës do ta vazhdojë angazhimin rreth kësaj teme për të sjellë drejtësi para qytetarëve të Kosovës.

Në anën tjetër, avokati Faton Fetahu ka thënë se ky është një vendim i padëgjues në vendimmarrjet gjyqësore të sistemit të Kosovës. "Është kusht që Gjykata Supreme t'i vlerësojë tri kushte para një vendimi dhe këtë nuk e ka bërë. Një prej këtyre kushteve është vlerësimi se a është ai vendim në dëm të interesit qytetar. Prandaj, gjykata nuk e ka bërë punën e saj në pajtim me ligjin, duke rënë ndesh me disa parime të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Supreme, me keqardhje e them, duket se e kishte të gatshëm këtë vendim", ka thënë avokati Fetahu.

Më tej, ai ka njoftuar se Partia Demokratike e Kosovës tani do ta dërgojë këtë vendim për interpretim në Gjykatën

Këshilli Prokurorial shpall konkurs për rekrutimin e 22 prokurorëve të rinj

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për rekrutimin e 22 prokurorëve të rinj.

Shpalljes së konkursit për rekrutimin e 22 prokurorëve të rinj fillimisht i ka paraprirë miratimi i Rregullores për rekrutimin, provimin, emërimin dhe rëmërimin e prokurorëve të shtetit.

Në mbledhjen e mbajtur të

premtën, KPK-ja ka themeluar edhe komisionin për rekrutim, me përbërje të kryesuesit Jetish Maloku, ushtruesit të kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, anëtarit të Këshillit, Agron Beka, kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, dhe anëtarë rezervë, anëtarit të Këshillit, Veton Shabani dhe prokurorja në zyrën e kryeprokurorit të shtetit, Laura Pula.

Më tutje, KPK-ja ka themeluar

edhe komisionin për rishqyrtim, i cili do t'i shqyrtojë ankesat të cilat mund të parashtrihen nga kandidatët.

Në përbërje të këtij komisioni, KPK-ja ka caktuar prokurorët Shqipdon Fazliu, Arjan Gashi dhe Idain Smailji. Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, më 13 qershor ka dekretuar shtatë prokurorë me mandat fillestar, pas propozimit të bërë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Në Paris të Francës janë takuar udhëheqësit e dy policive nga Kosova dhe Tunizia

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Gjatë qëndrimit në Paris të Francës, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka realizuar takimin e radhës me homologun e tij Mourad Hassine, drejtor i përgjithshëm i Sigurisë

Publike të Tunizisë. Në këtë takim njoftues u diskutuan tema që ndërlidhen me fushën e sigurisë, bashkëpunimit policor në forma të ndryshme si dhe për mundësinë e shkëmbimit të përvojave policore që mund të shërbejnë për të dy policitë.

Duke e parë nevojën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve që shërbejnë në interes të sigurisë globale, të dy udhëheqësit e policisë shprehën gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë në sfera të ndryshme.



Shtohen rastet e të infektuarve me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 200 testeve, 25 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të premten janë shëruar edhe pesë qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 225 274.

Në total numri i rasteve aktive me

Covid është 94.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 30 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 830 099 doza të vaksinës.

Deri më sot 823 524 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Gjithashtu, deri më sot janë dhënë 103 054 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) u ka bërë

thirrje qytetarëve që t'i bartin maskat në ambiente të mbyllura dhe të vaksinohen. "Kosova këto ditë shënon numër të vogël të rasteve të reja të Covid-19 dhe, për më tepër, fatmirësisht, nuk ka as raste të vdekjeve nga kjo sëmundje. Por, në vende të ndryshme të botës ende po regjistrohen raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia nuk ka mbaruar. IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë me testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve,

kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen", është thënë në thirrjen e IKShPK-së. Sipas këtij instituti, me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen që të

vaksinohen, me dozën e parë ata që ende s'janë vaksinuar, kurse të tjerët me dozën e dytë dhe dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19. "MSh-ja dhe IKShPK-ja rekomandojnë qytetarët që, përkundër situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjitëse dhe të vaksinohen kundër Covid-19", është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së.



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

MASHTI: Ka avancim në procesin e administrimit të pjesës së dytë të Testit të Arritshmërisë

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka njoftuar se, në bazë të raportit të nxjerrë nga informatat e mbledhura në terren, është vërejtur një avancim në procesin e administrimit të pjesës së dytë të Testit të Arritshmërisë që është mbajtur më 14 qershor.

MASHTI, me këtë rast, ka falënderuar drejtoritë komunale të arsimit për bashkëpunimin dhe angazhimin e shtuar për

eliminimin e problemeve gjatë procesit të mbajtjes së testit. "Megjithatë, edhe këtë herë janë evidentuar disa probleme në disa qendra të testimit si pasojë e mosrespektimit të udhëzimeve të hartuara nga MASHTI. Problemet e evidentuara gjatë mbajtjes së pjesës së dytë të testit të arritshmërisë janë: mospërmbajtja e rregullave dhe udhëzimeve nga komisionarët dhe administruesit e qendrave të testimit; vonesa të administruesve në disa qendra

të testimit dhe përdorimi i telefonave celularë nga nxënësit", është bërë me dije në njoftimin e MASHTI-t. MASHTI, gjithashtu, ka njoftuar lidhur me mosrespektimin e udhëzimeve gjatë mbajtjes së pjesës së dytë të Testit të Arritshmërisë janë marrë masat adekuate ndaj dy administruesve, ndërsa nxënësve të cilët kanë përdorur telefonin celular dhe që janë evidentuar nga administruesit do t'u llogariten vetëm pikët nga lëndët në pjesën e parë të testit.



Kosova, vendi i radhitur më së larti për pranimin e remitancave në Evropë


Miliona ekonomi familjare anembanë botës varen nga remitancat, një burim i të ardhurave të ekonomive familjare që vijnë nga anëtarët e familjes që kanë emigruar në vende më të zhvilluara për arsye ekonomike ose të tjera. Remitancat e emigrantëve përfaqësojnë në mënyrë kumulative flukse hyrëse esenciale financiare për shumë ekonomi në zhvillim. Kosova është vendi i radhitur më së larti për pranimin e remitancave në Evropë në përqindje të Bruto Prodhimit Vendor (BPV)

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Pavarësisht prej krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, remitancat e punëtorëve emigrantë në vitin 2020 kanë kapur shumën e jashtëzakonshme prej 548 miliardë dollarësh dhe parashikohen të arrijnë në 589 miliardë dollarë në vitin 2021. Megjithatë, kostoja e dërgimit të remitancave mbetet e lartë për shumicën e kanaleve të monitoruara të transferimit krahasuar me objektivat e vendosura nga G20 dhe OZHQ-të e OKB-së. Ulja e kostove të remitancave dhe rritja e shërbimeve të disponueshme për emigrantët dhe përfituesit e remitancave në mbarë botën mbetet në thelb të agjendës globale të zhvillimit. Në këtë kontekst, Banka Botërore (BB) është duke zbatuar projektin Greenback në disa vende të botës. Në Kosovë, Banka Botërore ka partneritet me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Kjo nisimë synon ta rritë efikasitetin e remitancave ndërkombëtare dhe t'i rritë përfitimet që ato sjellin për familjet individuale dhe ekonominë, kryesisht nëpërmjet edukimit financiar, ngritjes së kapaciteteve dhe koordinimit të palëve të

interesit.

Projekti Greenback fillon në komunitetet lokale që veprojnë si laboratorë për analizimin e çështjeve që lidhen me remitancat specifike për komunitetet, duke krijuar dhe pilotuar zgjidhje që mund të rriten për të përfituar si nga ana e ofertës ashtu edhe nga kërkesa e tregjeve të remitancave. Projekti promovon vazhdimisht bashkëpunimin midis palëve të interesit lokale dhe kombëtare për të mbështetur një ndryshim kuptimplotë. Megjithëse e kufizuar në shkallë, kjo qasje nga poshtë-lart prodhon mjete dhe mësim të nxjerra, të cilat kanë efekt të konsiderueshëm demonstrues për komunitete të ngjashme dhe mund të rriten lehtësisht përtej fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së përfshirjes së Bankës Botërore në secilin vend.

Miliona ekonomi familjare anembanë botës varen nga remitancat, një burim i të ardhurave të ekonomive familjare që vijnë nga anëtarët e familjes që kanë emigruar në vende më të zhvilluara për arsye ekonomike ose të tjera. Remitancat e emigrantëve përfaqësojnë në mënyrë kumulative flukse hyrëse esenciale financiare për shumë



ekonomi në zhvillim. Si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV), Kosova zë vendin e parë si vend pranues i remitancave në Evropë. Flukset hyrëse të remitancave vlerësohen të kenë arritur vlerën prej 1.5 miliardë dollarësh në vitin 2021, duke përbërë 16.7 për qind të BPV-së së Kosovës. Popullsia me prejardhje nga Kosova që jeton jashtë vendit

(diaspora), në vitin 2017 vlerësohet të jetë 833 739 persona, që është e barabartë me 46.36 për qind të njerëzve që jetojnë në Kosovë. Pandemia Covid-19 ka ngadalësuar migrimin e ri dhe ka rritur migrimin e kthimit për herë të parë në historinë moderne. Kjo ka vënë në sprovë sektorin e remitancave dhe ka bërë që flukset e

remitancave të bien gjatë muajve mars dhe prill 2020. Megjithatë, flukset e remitancave janë rikuperuar në muajt në vijim të vitit 2020 dhe gjatë gjithë vitit 2021, pasi emigrantët vazhduan të dërgojnë para në shtëpitë e tyre, duke grumbulluar nga kursimet e tyre ose fondet e tjera emergjente në të cilat kanë pasur qasje.

ATK-ja: Personat të cilët merren me aktivitete afariste janë të detyruar t'i deklarojnë tatimet

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua ka rikujtuar të gjithë personave të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor, janë të obliguar të: regjistrohen, mbajnë dokumentacion, deklarojnë dhe t'i paguajnë saktë detyrimet tatimore. "Bazuar në planin strategjik 2022-2026 dhe planin e trajtimit të rreziqeve për vitin 2022, ATK-ja ka hartuar planin e veprimtimit për ta përmirësuar përbushjen tatimore 'Mungesa në stoqe dhe malli



pa origjinë', ku përmes këtij plani do të kryejë aktivitete intensive të tatimpaguesit me qëllim të identifikimit të personave, të cilët nuk

përbushin detyrimet e tyre të përcaktuara me ligj", ka njoftuar ATK-ja. Ky institucion u ka bërë thirrje të gjithë personave që t'i

përbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor, si: Deklaroni dhe paguani saktë tatimin; Mbani dokumentacionin sipas ligjit; Dokumentoni mallrat në stoqe sipas kërkesave ligjore; Dokumentoni mallrat të cilat i mbani në konsignacion; Dokumentoni mallrat gjatë transportit; Dokumentoni mallrat gjatë shitjeve ambulante; Lëshoni faturë tatimore për transaksionet biznes për biznes; Lëshoni kupon fiskal për transaksionet biznes për konsumatorin final (person fizik joafarist) etj. ATK-ja inkurajon të gjithë

personat fizikë afaristë dhe personat juridikë t'u përgjigjen detyrimeve tatimore, në të kundërtën do të ndërmerren masat e përcaktuara me legjislacionin tatimor. "Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore ju kontribuoni direkt në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore. Dokumentimi i mallit është obligim ligjor!", ka njoftuar ATK-ja.

Kostandini i Madh: Pushtuesi i krishterë i Romës së Lashtë



Konstandini I ishte perandori i parë dhe i vetëm romak që mori titullin "I Madh". Një udhëheqës revolucionar dhe i pandalshëm, ai ishte gjithashtu perandori i parë që u konvertua në besimin e krishterë, duke shpallur krijimin e një Perandorie të re Romake, akt që do të sillte në fund edhe rënien e saj.

Po kush ishte Kostandini i Madh? Lindi në qytetin Naisus (në Serbinë e sotme) më 27 shkurt 272 Pas Krishtit. I ati i tij, Flavius Konstancius, ishte një nga truprojat e perandorit të atëhershëm Aurelianit. E ëma e Kostandinit, ishte një grua greke e varfër me emrin Helena. Konstancius i ngjiti shpejt shkallës e karrierës në radhët e ushtrisë romake, duke u bërë guvernator i provincës romake të Dalmacisë. Në vitin 284, Diokleciani u bë sundimtari i ri i Perandorisë Romake. Disa vite më vonë, ai emëroi si bashkë-perandor mikun e tij të ngushtë Maksimianin.

Në vitin 288, Maksimiani deklaroi se Konstanci do t'i bashkohej prefektit të tij në provincën e Galisë, që sot përbëhet nga Franca, Luksemburgu, Belgjika dhe Zvicra. Më vonë, Maksimiani do të emëronte Kostancin mëkëmbës të tijin në Çezare në Tetrarkinë e Dioklecianit.

Gjatë asaj kohe, Kostandini i ri u rrit dhe nisi të shërbejë si trashëgimtari i të atit, deri në vdekjen e tij në vitin 306. Kostandini kishte marrëdhënie të afërta me paganët dhe të

krishterët. Megjithëse u rrit si pagani, ai ishte tolerant ndaj kësaj feje.

Kostandini zhvilloi në emër të Dioklecianin në disa luftëra në Siri, Mesopotami dhe madje edhe Britani. Pikërisht në Jork të Anglisë vdiq Konstanci në vitin 306. Para vdekjes së tij, ai shpalli synimin e tij për ta bërë perandor djalin e tij Kostandinin. Provincat e Galisë dhe Britanisë ndoqën shumë shpejt shembullin e tij.

Kostandini e shpalli veten Çezar, gjë që sfidoi direkt bashkësundimtarin e tij Maksentius. Si perandori i ri i Romës, Kostandini sundoi mbi një nga ushtritë më të mëdha romake në Gali, Britani dhe Spanjë. Ai drejtoi disa projekte infraskrukturore të mëdha në kryeqytetin gal, Trier, ku përfshiheshin fortifikime të rikonstruara, një kompleks i madh pallatesh, një sallë audiencash, dhe një banjë perandorake.

Menjëherë pas fillimit të mbretërimit të tij, pati shumë komente se sundimi i Kostandinit ishte i ngjashëm me atë të babait të tij. Deri në vitin 311, ai sundonte mbi perandorinë perëndimore, ndërsa një sundimtar i ri, Licinius, kontrollonte Lindjen. Maksentius u ndje i tradhtuar nga humbja e papritur e pushtetit, dhe nisi një luftë hakmarrëse kundër Kostandinit. Ai mori kontrollin e gjithë Italisë, ndërsa Kostandini u zhvendos në Milano për ta rifituar atë. Kur

po marshonte drejt Maksentiusit, ushtria e tij mbajti për herë të parë pankarta me shkronjat greke X (chi) dhe P (rho) që shkruanin "Krishti".

Kostandini pretendoi se Zoti i kishte folur, dhe e kishte udhëzuar të mbante këto banderola për të siguruar fitoren. Ushtria e Kostandinit e mundi atë të Maksentiusit. Licinius u detyrua të dorëzonte fronin e tij në këmbim të faljes së jetës. Por pasi mori pushtetin, Kostandini e vrau. Për herë të parë në shumë vite, Roma kishte një perandor të vetëm.

Dhe për herë të parë në histori, ai ishte i krishterë. Paraardhësi i Kostandinit, Dioklecianikishte zgjedhur Nikomedian (në Turqinë e sotme) si selinë e tij të pushtetit në Lindje. Por perandori i ri pranoi zhvendosjen e qendrës së perandorisë së tij drejt Bizantit. Ai zgjodhi të krijojë një kryeqytet të ri të Perandorisë Romake Lindore, Kostandinopojën, e cila u shndërrua në një qendër të mësimin të krishterë dhe ruajtjes së kulturës. Qyteti strehonte relike të famshme siç ishte Kryqi i Vërtetë, që besohet se ishte kryqi mbi të cilin u kryqëzua Jezu Krishti 300 vjet më parë, dhe Shkopin e Moisiut.

Kostandini e ndërtoi Kishën e Shenjtë të Apostujve të Shenjtë në majë të tempullit të vjetër të perëndeshës greke Afërdita. Perandori i krishterë i sapokonvertuar, mori përgjegjësinë për politikën e re fetare në Perandorinë Romake,

për të ndalur armiqësinë në rritje midis paganëve romakë dhe të krishterëve.

Në një përpjekje për të lehtësuar disi tensionet, Kostandini e legalizoi Krishterimin, dhe i ndaloi të krishterët të merrnin pjesë në fenë pagane, gjë që nxiti luftën ndaj të krishterëve jo-praktikantë. Në një përpjekje për të forcuar harmoninë shoqërore, Kostandini mblodhi një këshill peshkopësh që udhëtuan në qytetin e Nikesë për t'u mësuar njerëzve parimet bazë të Krishterimit.

Duke ndalur persekutimin intensiv kundër të krishterëve në të gjithë Perandorinë, dhe duke deklaruar se të krishterët mund të ndiqnin lirshëm besimin e tyre, Kostandini ndryshoi praktikisht brenda natës politikën fetare.

Kostandini druhej se mund të kishte fatin e shumë perandorëve romakë përpara tij: një grusht shteti ushtarak që përfundonte me vrasje. Për të minimizuar këtë rrezik, ai e riorganizoi të gjithë sistemin e senatit, duke i dhënë më shumë pushtet guvernatorëve provincialë që ubesonte më shumë.


Perandori e reformoi edhe ushtrinë, duke shpërbërë legjionet që ai besonte se kërcënonin pushtetin e tij, duke përmirësuar aftësitë e armëve, për të mbajtur larg kryeqytetin tradhtarët e mundshëm nga radhët e ushtrisë. Kostandini nuk ishte i vetmi në familjen e tij që arriti njëfamë ndërkombëtare.

E ëma e tij, Helena, u bë Shën Helena e Kostandinopojës, pasi ndërmori një pelegrinazh në Tokën e Shenjtë. Ajo supozohet se ri-zbuloi Kryqin e Vërtetë. Por jo e gjithë familja e Kostandinit u shpall shenjtore. Djali i tij më i madh Krispus dhe gruaja e tij, Perandoresha Fausta, u dënuan të dy me vdekje me urdhër të Perandorit.

Emrat dhe imazhet e tyre u fshinë nga të dhënat historike. Në atë kohë, shumë njerëz spekuluan se Krispus dhe Fausta ishin në një marrëdhënie intime të paligjshme. Krispus u helmua në qershorin e vitit 326, ndërsa Fausta u vra një muaj më vonë.

Kostandini vdiq më 22 maj 337. Pas një sëmundjeje të gjatë, ai shpresonte të pagëzohej përpara vdekjes së tij në lumin Jordan. Por perandori i sëmurë nuk arriti kurrë në Tokën e Shenjtë. Ai vdiq teksa po përpiqej të arrinte në qytetin e tij, Kostandinopojë.

Trupi i tij u varros në Kishën e Apostujve të Shenjtë, por më vonë u përdhos dhe u shkatërrua gjatë Kryqëzatës së Katërt në vitin 1204. Kisha e Apostujve të Shenjtë u shkatërrua gjatë kryqëzatatave, ndërsa vendndodhja e varrit të Kostandinit, u harrua me kalimin e kohës. Djemtë e tij Kostandini II, Konstanci II dhe Konstani e sunduan Perandorinë pas babait të tyre. Gjatë mbretërimit të tij, Kostandini i Madh ribashkoi Romën e Lashtë nën një perandor, dhe e zgjeroi perandorinë e tij në atë që do të bëhej më vonë Evropa. /Vintage News - Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Champions League fton Yllin të aplikojë për pjesëmarrje në raundin kualifikues

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Basketball Champions League nëpërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) e ka ftuar skuadrën kampione të Kosovës (Art Motion Superliga 2021/22), KB Golden Eagle Ylli, për të aplikuar për pjesëmarrje në raundin kualifikues të kësaj gare për edicionin 2022/23. KB Golden Eagle Ylli e ka kompletuar dokumentacionin e kërkuar nga Basketball Champions League, të cilin nëpërmjet FBK-së e ka përcjell te departamenti i garave të kësaj lige prestigjioze të

basketbollit. Pjesëmarrja në edicionin e rregullt të Basketball Champions League apo në raundet kualifikuese për çdo klub mbetet në kompetencat e bordit të kësaj lige, i cili do ta konfirmojë listën përfundimtare të klubeve pjesëmarrëse deri të premten më 24 qershor 2022. Kujtojmë se KB Golden Eagle Ylli është shpallur kampion i Kosovës për edicionin 2021/22 duke triumfuar në serinë finale të "play-off"-it në Art Motion Superligë 3:1 ndaj Trepçës.



Alban Dragusha emërohet trajner i Vushtrrisë



VUSHTRRI, 17 QERSHOR - Ish-futbollisti i mirënjohur, Alban Dragusha, e ka marrë drejtimin e skuadrës së Vushtrrisë. Dragusha, i cili ishte pjesë e Dritës si ndihmëstrajner i Ardian Nuhiut, ka vendosur të marrë më shumë përgjegjësi në

karrierën e tij dhe ta udhëheqë skuadrën Vushtrrinë me objektiv rikthimin në elitën e futbollit. "Alban Dragusha do të jetë kryetrajner i klubit tonë. Pas një karriere të bujshme si futbollist, duke luajtur për skuadra vendore dhe ndërkombëtare, ndër to edhe

kampion me klubin tonë në vitin 2014, tani Albani rikthehet në Vushtri, por këtë herë si kryetrajner. I dëshirojmë mirëseardhje dhe i urojmë shumë suksese 'Gladiatorit' tonë! Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë.

Premtohet spektakël në FIBA 3x3 Challenger Prishtina



PRISHTINË, 17 QERSHOR - Të enjten mbrëma në sheshin "Zahir Pajaziti" është organizuar konferenca e parë për medie kushtuar garës ndërkombëtare FIBA 3x3 Challenger që do të mbahet më 16 e 17 korrik në Prishtinë. Në konferencën e parë për medie ishin të pranishëm ministri për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku, kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe drejtori i klubit 3x3 Prishtina, Fisnik Juniku, të cilët u zotuan se kjo ngjarje do të jetë një spektakël i vërtetë. Për herë të parë në Kosovë, më saktësisht në Prishtinë, do të organizohet

një ngjarje prestigjioze siç është Challenger 3x3 Prishtina. Organizator i kësaj ngjarjeje madhështore është Klubi 3x3 Prishtina në mbështetje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), komuna e Prishtinës dhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK). Në këtë Challenger do të marrin pjesë 12 ekipe të huaja dhe 4 ekipe nga Kosova (përmes Wild Card). Shpërblimin për vendin e parë, dytë dhe të tretë në total është 40 mijë euro. Po ashtu, finalistët kualifikohen për në Debrecen të Hungarisë, në Masters, në ngjarjen më të madhe që mbahet.

Edhe Lazio e dëshiron Brojën

Romë, 17 qershor - Sulmuesi shqiptar Armando Broja shkëlqeu sezonin e fundit në fanellën e Southampton, ku ishte i huazuar nga Chelsea. Pas paraqitjeve shqiptari ka

zgjuar interesim nga shumë klube, derisa e fundit që e dëshiron Brojën është Lazio. Drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare ka kërkuar nga Chelsea informata shtesë rreth 20-

vjeçarit, i cili ka kontratë me klubin anglez deri më 30 qershor 2026. Bazuar në "Transfermarkt", anëtari i Kombëtares së Shqipërisë vlerësohet me 22 milionë

euro në treg. Për Armando Brojën besohet se interesim kanë shfaqur edhe Napoli, Atalanta, Borussia Dortmundi, West Ham Unitedi e Evertoni.



Strakosha: Që fëmijë ëndëroja të luaja në Angli

LONDËR, 17 QERSHOR - Thomas Strakosha është në kërkim të skuadrës së re pasi ka mbyllur kontratën me Lazion. Portieri shqiptar fitoi dy Kupa dhe Superkupa në Itali me bardhekaltrit nga Roma.

Kontrata i ka përfunduar dhe 27-vjeçari do ta zgjedhë lirisht klubin e radhës në karrierë. Sirenat angleze nuk kanë munguar. Fulhami i ka bërë një ofertë konkrete teksa ka interesim edhe nga

Chelsea. Strakosha ëndërronte që kur ishte fëmijë kalimin në Premierë Ligë, ndërkohë që foli për gazetarin Fabrizio Romano në lidhje me situatën e tij dhe interesimin nga ishulli. "Jam

vërtet i nderuar që emri im lidhet me një klub të madh si Chelsea. Është një ëndërr. Unë kam ëndërruar për të luajtur në Premierë Ligë që kur kam qenë fëmijë", ka deklaruar Strakosha.



Golden State shpallet kampion në NBA

BOSTON 17 QERSHOR - Skuadra e Golden State Warriorsit u shpall kampione e NBA-së për sezonin sportiv 2021-2022. Ajo fitoi me rezultat 103-90 në fushën e Boston Celticsit në ndeshjen e gjashtë, duke triumfuar 4-2 në serinë e takimeve finale. Ky është titulli i katërt kampion për Warriorsin në shtatë vjetet e fundit, çka tregon për një ekip që ka një bazë solide. Basketbollisti Stephen Curry mori trofeun MVP të finaleve, duke qenë edhe protagonist në fushë me 34 pikët e tij. Për të ky është titulli i katërt në karrierë, ashtu sikurse edhe për Klay Thompsonin e Draymond Greenin, treshja që ka qenë gjithnjë së bashku, të drejtuar nga

trajneri Steve Kerr, që besoi te ky grup kampion. Ndryshe nga tri titujt e mëparshëm, këtë trofe skuadra e Golden States e ka fituar me shumë vështirësi, një ekip që dy sezone më parë arrinte vetëm 15 fitore në sezonin e rregullt. Thompsoni ishte jashtë fushës për gati dy vjet, ndaj ekipi iu besua mjaft të rinjve (Jordan Poole), që u ndërthurën mirë me veteranët. Bostoni rezistoi, por nuk mundi t'i bëjë ballë një ekipi solid si Warriorsi, por finalistët kanë hedhur bazat për një të ardhme premtuese. Në ekip janë dy lojtarë "big" nën 25 vjeç (Jayson Tatum e Jaylen Brown), që do të dinë të rikthehen protagonistë në sezonin e ardhshëm. Për sa i

përket ndeshjes, ajo nisi mirë për Bostonin (14-2), por shpejt miqtë rikuperuan dhe u shkëputën +21 pikë (54-33). Vendasit përipiqen të reagojnë dhe ngushtojnë shifrat në 10 pikë (76-66), por vetëm kaq. Në periodën e fundit Warriorsi u shkëput e fitoi 103-90 falë 34 pikëve të Curryt (34 realizoi edhe Browni për vendasit). Një triumf i merituar i një ekipi që e rriti lojën me kalimin e kohës, për të qenë në "top" në fazën "play-off", kur dhe u rikuperuan të gjithë lojtarët. Pas ndeshjes nis festa e parë, ajo e dorëzimit të trofeut nga drejtuesit e NBA-së, por festa kryesore do të zhvillohet pasi skuadra të mbërrijë në shtëpinë e saj, me fansat e saj.



Legjenda Hugo Sanchez: Mbappe nuk e refuzoi Realin, i tha ta presë

MADRID, 17 QERSHOR - Mungesa e transferimit të Kylian Mbappes te Real Madridi vazhdon të komentohet në Spanjë. Ylli francez ishte shumë afër kalimit në "Santiago Bernabeu", por në fund zgjodhi milionat e kampionëve të Francës. Sulmuesi 23-vjeçar rinovoi deri më 2025 me PSG-në. Legjenda e Real Madridit, Hugo Sanchez, komentoi situatën e krijuar nga Mbappe në prononcimin për "Marca", duke mos e cilësuar ta mbyllur mundësinë e transferimit të lojtarit në La Liga në të ardhmen. "E kam të vështirë të flas për vendimin e Mbappes, pasi unë nuk jam brenda kokës së tij, as nuk jam ai. Por, unë e ndiej se ai nuk i ka thënë 'jo' Realit, thjesht 'më pritni pak!' Ai u përball me një presion të madh për të qëndruar në Francë. Edhe familjarët mund t'i kenë bërë presion. Ata kanë ndikuar në



vendimin e tij për ta rinovuar kontratën", ka thënë Sanchez. "Real Madridi ishte dëshira dhe ëndrra e tij, por ëndrrat mund të presin pak kohë për t'u realizuar. Unë mendoj se ai po tregon shenja se dëshiron të shkojë te Reali një ditë...

Sigurisht që Kylian fiton më shumë para te PSG-ja, por nuk është një çështje parash. Ai deklaroi se nuk mund të tradhtonte situatën e tjerë që janë më të forta se paratë, kështu që duhet ta kuptojmë", ka deklaruar Sanchez.

SHKURT

Manaj largohet nga Spezia, kthehet te Barcelona

Sulmuesi i kombëtares shqiptare, Rei Manaj, ka mbyllur aventurën e tij me Spezian, duke u kthyer sërish te Barcelona. Klubi italian insistoi me ngulm që t'i merrte shërbimet e shqiptarit, por rroga e Manajt ishte problem dhe kështu bëri që ai të kthehej në Katalunjë. Me anë të një fotoje të postuar në "Instagram", Manaj shkruan: "Faleminderit të gjithëve dhe paçi fat! Faleminderit, gjithashtu, të gjithë fansave që e kanë bërë këtë qytet magjik".

Dzeko realizoi 17 gola, por Interi e nxjerr në shitje

Sulmuesi Edin Dzeko ka realizuar 17 gola dhe 10 asistime me fanellën e Interit, por skuadra italiane ka vendosur ta nxjerrë në shitje. Synim i skuadrës nga Milano është rikthimi i Romelu Lukakut dhe transferimi i Paulo Dybalas. Me këto dy transferime Interi do të ketë një listë të stërmbushur me sulmues dhe sulmuesi boshnjak nuk do të ketë më vend. Ashtu sikurse nuk do të ketë as për Sanchezin, derisa Correa dhe Lautaro Martinez nuk do të largohen.

Mourinho ëndërron transferimin e Ronaldos

AS Roma dhe Jose Mourinho thuhet se po "ëndërrojnë" një transferim shokues të Cristiano Ronaldos. Pavarësisht se trajneri i ardhshëm i Manchester Unitedit, Erik ten Hag, përshëndeti golashënuesin më të mirë të ekipit, Ronaldo mund të mos jetë pjesë e projektit të holandezit. Sipas "La Repubblica", Ronaldo rrezikon të bëhet "mysafir" në planet e Ten Hag. Stili i lojës së Ten Hag mund ta bëjë Ronaldon të përipiqet të përshtatet. Ekipet e holandezit janë ndërtuar për ta shtypur dhe kontrolluar topin si një njësi kolektive. Raporti vazhdon të thotë se pasiguria e Ronaldos në United intereson Romën e Mourinhos, të cilët po "ëndërrojnë" të arrijnë një marrëveshje kaq të madhe. Para pak kohësh një gazetar italian theksoi drejtpërdrejt në transmetim se Roma do ta realizojë transferimin më të madh të të gjitha kohëve.

Mane në Bayern, mungon vetëm zyrtarizimi

Sadio Mane shumë shpejt do të jetë zyrtarisht një lojtar i Bayern Munchenit. Konfirmimi vjen nga mediet ndërkombëtare. Liverpool do të përfitojë 40 milionë euro, që mund t'u shtohen edhe 10 milionë të tjerë në varësi të bonuseve të ndryshme, që çon në 50 milionë euro investimin total. Trajneri Jurgen Klopp në këtë mënyrë mbetet pa një nga lojtarët kryesor. Mane ka edhe një vit kontratë me "të kuqtë" dhe u ble nga Southamptoni në vitin 2016 për 40 milionë euro.

Ronaldo e fton Marcelon në Valladolid

Marcelo i dha fund karrierës së tij me Realin e Madridit teksta të hënën e kaluar shpalli edhe lamtumirën nga klubi. Ai la "Los Blancos" pas 16 vjetësh, por fitoi 25 trofe dhe tani është vënë në kërkim të një klubi të ri. Mediet spanjolle njoftuan se tri klube nga Emiratat e Bashkuara Arabe, Katari dhe Turqia, i kanë ofruar një mundësi brazilianit. Por në orët e fundit po qarkullojnë zërat se Marcelo mund ta vazhdojë karrierën e tij në Spanjë. Ai mund të qëndrojë në La Liga, teksa Valladolidi i ngjitur në këtë sezon në Primera ka shfaqur interes për të. Në këtë drejtim ka ndihmuar jo pak Ronaldo da Lima, i cili është dhe president i Valladolidit. Ronaldo ka kontaktuar me Marcelon, duke i bërë propozimin e tij. Tani fjalën e ka mbrojtësi i majtë.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Deklaroni të ardhurat dhe paguani tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, se janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimin dhe Kontributet Pensionale.

Për personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimet dhe Kontributet Pensionale, ATK do të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Andaj, ATK, u bënë thirrje të gjithë personave që të deklarojnë të ardhurat e krijuara apo të korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tatimore, kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Pagesa e tatimit, siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend!

Administrata Tatimore e Kosovës

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Mon Caffè AAB” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811848194 me pronar Adnan Ademi Vushtrri, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mon Caffè AAB” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811848194 Adnan Ademi Vushtrri ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Mon Caffè AAB” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811848194 Adnan Ademi Vushtrri the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Resmija Arifi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- ▶ Besnik Gjini nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III të Sh.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- ▶ Isak Kukaj shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën, testin e maturës, certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Lulzim Fetahu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Hysni Temaj" Kushnin Has.
- ▶ Nexhmedin Kacamak shpall të pavlefshme dëftesën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Suzan Kovaci shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- ▶ Mergim Asani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

